

- Bazë e plotë të dhënash për procedurat e mëtejshme të regjistrimit dhe pajisjes me dokumentacion pronësie.

Monitorimi dhe raportimi

Procesi do të monitorohet nga Drejtoria Pl. të Territorit dhe grupi i punës, të cilët do të raportojnë periodikisht te kryetari i Bashkisë, mbi ecurinë e inventarizimit dhe problematikat e evidentuara gjatë zbatimit të planit të punës.

Hartoi: ing. Lindita Hyseni, drejtorja e Planifikimit të Territorit,

Miratohet:

KRYETARI

RROK DODAJ



Faza e zbatimit dhe kalendari i aktiviteteve,

| Nr. | Aktiviteti | Afati | Përgjegjësi |
|-----|--|-------------------|--|
| 1 | Krijimi i grupit të punës për inventarizimin | 1-5 Qershor | Kryetari i Bashkisë, Drejtorja pl. të Territorit |
| 2 | Grumbullimi i dokumentacionit ekzistues të pronave | 8-12 Qershor | Zyra Urbanistikes Dr. Pyjeve |
| 3 | Evidentimi dhe verifikimi në terren i pronave të azhornuara | 15-26 Qershor | Zyra Urbanistikes Dr. Pyjeve |
| 4 | Krahasimi i të dhënave me dokumentacionin teknik dhe kadastral | Java 1 e Korrikut | Zyra Urbanistikes Zyra Juridike |
| 5 | Përditësimi i regjistrit të inventarit | Java 2 e Korrikut | ASHK Zyra Urbanistikes Dr. Pyjeve |
| 6 | Hartimi i raportit përfundimtar të inventarizimit | Java 3 e Korrikut | Zyra Urbanistikes Dr. Pyjeve |
| 7 | Dorëzimi dhe miratimi i raportit përfundimtar | Java 4 e Korrikut | Drejtorja Pl. Territorit Kryetari i bashkisë |

Dokumentacioni që do të përdoret

- Regjistri i pronave bashkiake (do mundësohet nga ASHK lista e pronave të regjistruara deri në këtë fazë)
- Dokumentacioni teknik i azhornuar
- Hartat dhe planvendosjet
- Certifikatat e pronësisë (ASHK)
- Aktet administrative dhe vendimet përkatëse
- Procesverbalet e verifikimit në terren
- Në bashkëpunim me qytetraët dhe ministrinë e financave do të përditësohet lista e pronave të privatizuara ose në proces privatizimi,

Rezultatet e pritshme

- Inventar i përditësuar i pronave bashkiake.
- Evidentim i saktë i gjendjes juridike dhe fizike të pronave.
- Përmirësim i administrimit dhe menaxhimit të pronës publike.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKË
DREJTORIA E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT DHE INVESTIMEVE PUBLIKE

Nr. 478 / Prot.

Pukë më 14.03 2025

PLAN PUNE

Për inventarizimin e pronave të Bashkisë Pukë

Qëllimi

Ky plan pune përgatitet në përgjigje të detyrave funksionale të zyrës si dhe kërkesave për raportim për treguesit e Planit të Integritetit të bashkisë Pukë dhe ka për qëllim organizimin dhe realizimin e procesit të inventarizimit të pronave bashkiake të azhornuara, evidentimin e gjendjes aktuale të tyre dhe përditësimin e dokumentacionit përkatës administrativ dhe teknik.

Objektivat

- Evidentimi i plotë i pronave bashkiake të azhornuara.
- Verifikimi i dokumentacionit teknik dhe ligjor të pronave.
- Përditësimi i regjistrave të inventarit.
- Krijimi i një baze të saktë të të dhënave për administrimin e pronave bashkiake.
- Përcaktimi i prioriteteve për pajisjen me dokumentacion pronësie.